



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Librazhd më: 25.08.2025

NJOFTIM

“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”


Z.znj. _____

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Premte, datë 29.08.2025**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Gusht** 2025. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.07.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha korrik 2025”.
4. **P/Vendim** “Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 , VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
5. **P/Vendim** “Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 , VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
6. **P/Vendim** “Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kopetencave të përbashkëta midis njësive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA).
7. **Të ndryshme:**
 - *Informacion për gjendjen dhe masat e marra për krijimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për fillimin e procesit mësimor në të gjitha godinat arsimore që ka në juridiksion Bashkia Librazhd.*
 - *Ditën e enjte datë 28.08.2025 ora 10:00 të mbledhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU



PROCEVERBAL

- I mbajtur sot më datë 29.07.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga ZV/Kryetare e Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 16 vota pro.
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 24.06.2025 me të gjitha votat e të pranishmëve 16vota pro.Në mbledhjen e muajit Gusht këshilltarët kërkojnë informacion ne lidhje me P/vendimin "Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Librazhd midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Librazhd.
- Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:
 1. Miratimi i rendit të ditës.
 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.07.2025.
 3. **P/Vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha qershor 2025".
 4. **P/Vendim** " Për miratimin e Planit Shërbimeve Sociale periudha 2025-2028"
 5. **P/Vendim** " Mbi miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore për periudhën Shtator 2025-Shtator 2028"
 6. **P/Vendim** " Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Librazhd"
 7. **P/Vendim** " Për miratimin e shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Librazhd për vitin 2025-2029".
 8. **P/Vendim** "Për miratimin e tavaneve përgatitore për projekt-buxhetin afatmesëm 2026-2028".
 9. **P/Vendim** " Për miratimin e projektit të pare buxhetor afatmesëm 2026-2028"
 10. **P/Vendim** " Përdorim fondi rezervë "Bashkëfinancim ndërtimit të dy shtëpive për dy familje me kushte të rënda ekonomike".
 11. **P/Vendim** " Për dhënie ndihme financiare".
 12. **P/Vendim** " Përdorim fondi rezervë "Bashkëfinancimin e projektit Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara"
 13. **P/Vendim** "Për zgjerimin e varrezave të qytetit Librazhd në Semës".
 14. **P/Vendim** "Për zgjerimin e varrezave të qytetit Librazhd tek Fusha e Manës".
- *Diskutimi I analizës së të dhënave të barometrit për zbatimin e legjislacionit për barazinë gjinore 30% në bashkinë Librazhd.*
- 15. Të ndryshme:

Fillimi I mbledhjes:

P/Vendimi nr 1 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha qershor 2025”.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

Jam kundra me ato foto që publikohen ne Facebook,ku punonjsit e Administratës dalin për pastrim,ku braktisin zyrat për disa ore dhe mbas pastrimit kthehen prapë ne zyrë,e shikoj si jot ë hijshme këtë pjesë.Unë jam i mendimit që të dalin për pastrim një herë në muaj të gjithë pëfituesit e Ndihmës Ekonomike.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Dua një sqarim në lidhje me Drejtorët e Bashkisë që kanë dhënë dorheqje,çfarë vendesh janë vakante? Të kemi dhe ne si Këshill Bashkiak një Informacion më të detajuar.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

A janë pranuar këto dorheqje nga Kryetari I Bashkisë apo janë thjeshtë për formalitet?

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Tani çdo Drejtor që ka ardhur sot në mbledhje për të mbrojtur p/vendimet është në mardhënie pune.Në lidhje me pjesën tjetër që kanë dhënë dorheqje është ngritur një komision i veçantë,ku do të kryhet një analize me detaje për çdo Drejtor.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

2.P/Vendim“ Për miratimin e Planit Shërbimeve Sociale periudha 2025-2028”

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak ne kemi sjellë disa plane për ti miratuar, këto plane na rrisin pikët për Grantin që marrim nga Qeveria.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

E lexova me vëmendje relacionin e përgatitur nga specialistët e zyrës dhe I falenderoj për punën e bërë.Por shikoj që nuk ka asnjë reagim në lidhje me rritjen e tarifës së ujit të pijshëm.Pse duhet ti rritet çmimi I ujit qytetit të Librazhdit,ku ne kemi ujin të lirë,e kemi me rrjedhje të lirë.A nuk futet të çështjet sociale dhe kjo pike?Çfarë vlere ka në qoftë se rriten rrogat,ku me keto çmime që rriten dita ditës.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

A ka informacion Bashkia në lidhje me rritjen e çmimit të ujit?Kenë njoftim zyrtar në lidhje me këtë pike?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Nuk kam asnjë informacion në lidhje me këtë pike.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Si ka mundësi ku ju shpreheni se nga 8000 minje gra përfitojnë ndihmë ekonomike vetëm 4000 minje, I bie të kemi një varfëri ekstreme. Shikojeni mos e keni gabim si shifër. Ju mensën Sociale e mbyllët sepse skeni fonde.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 17 vota pro.

3.P/Vendim “Mbi miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore për periudhën Shtator 2025-Shtator 2028”

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **17 vota pro.**

4. P/Vendim “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Librazhd”

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Pse vjen me rritje çmimi I mbetjeve? Pse të gjitha vitet janë me vlerë të njëjtë? Shikoj që këta të pastrimit e mbushin ate makinën te Zjarrfiksj dhe çmimi I ujit I rritet qytetarëve?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në lidhje me rritjen e tarifës së pastrimit, bashkia Librazhd ka shtruar shumë rrugë të fshatrave me asfalt dhe detyrimisht do rritet dhe tarifa e shërbimit sepse ne cdo rrugë me asfalt do ketë koshat për mbeturinat dhe do shkoj makina e pastrimit. Kurse se ku mbushin ujin nuk kam informacion.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me **14 vota pro dhe 3 kundër.**

5.P/Vendim “Për miratimin e shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Librazhd për vitin 2025-2029”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët pasi diskutimi është i njëjtë me planin e menaxhimit të mbetjeve.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 14 vota pro dhe 3 kundër.

6.P/Vendim “Për miratimin e tavanëve përgatitore për projekt-buxhetin afatmesëm 2026-2028”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Shikoj që në fund të relacionit mungojnë disa firma, këta që nuk kanë firmosur nuk janë dakort apo si?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ata që nuk kanë firmosur janë me leje, duke qënë që është sezon pushimesh dhe ju duhet të na mirkuptoni.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **17 vota pro.**

7.P/Vendimi “Për miratimin e projektit të pare buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

8.P/Vendim “Përdorim fondi rezervë “Bashkëfinancim ndërtimit të dy shtëpive për dy familje me kushte të rënda ekonomike”.

Këshilltaria Fatbardha Qatja e merr fjalën.

A nuk do ishte mire që këto bashkëfinancime të ishin të prashikuar dhe mos prekeshe fondi rezervë? Këto dy familje nga kush janë perzgjedhur pasi mos kemi pakënaqësi nga familje te tjera që janë në nevojë? Deri ne cfare pike do ti ndihmojë bashkia keto familje?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Keto familje janë perzgjedhur nga vetë Shoqata. Si fillim Bashkia keto familje do ti ndihmoje deri ne ndertimi e shtepise pastaj te shikojme ndonje mundesi tjeter.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

9.P/Vendim “Për dhënie ndihme financiare”.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro.**

10.P/Vendim “Përdorim fondi rezervë “Bashkëfinancimin e projektit Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”

Këshilltaria Fatbardha Qatja e merr fjalën.

A nuk ka menduar ndonjë plan(b) bashkia sepse e ka sjelle si ne limite per ta miratuar kete p/vendim, sepse e zeme se keshilli nuk e miraton??

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Pse nuk I kemi emrat fitues ne dispozicion pasi akoma nuk dime cfare emrash jane fitues.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ky program ka afat sepse ne tani jemi ne fazen e bashkefinancimit,sa I perket emrave do jua sjellim në mbledhjen e radhes.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro.**


11. **P/Vendim** “Për zgjerimin e varrezave të qytetit Librazhd në Semës”.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro.**

12. **P/Vendim** “Për zgjerimin e varrezave të qytetit Librazhd tek Fusha e Manës”.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro.**

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA



ZV/KRYETAR I KËSHILLIT
Silvana HOXHA





21/11 vendim
51=1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMJA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

PROJEKT-VENDIM

Nr.20 Datë 12.08.2025

Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike
nga fondi i Kushtezuar 6%
(Periudha: KORRIK 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezulton se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 81 Familje, dhe propozohet:

- 1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6%: Gjithsej 81 Familje me një fond: **332,004** lekë. Vlera e ndihmës **263,740** lekë, vlera e energjisë **68,264** lekë
- 2-Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga fondi i kushtezuar 6% nuk ka familje.
- 3-Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
- 4-Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.
- 5- Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

RELACION

Nr.20 datë 12.08.2025

Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike
nga Fondi i Kushtëzuar 6%
(Periudha: KORRIK 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” percaktohet qarte se kush mund ta përfitojë këto ndihme nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndësishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituese në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftueshme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërorë i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike, sociale, shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitojë ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik në familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 81 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 81 familje.

2- Te mos përfitojnë nuk ka familje.

Njesitë Administrative:

1. Njësia Administrative Qytet	32 Familje me fond	128,422 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	14 Familje me fond	66,380 lekë
3. Njësia Administrative Polis	12 Familje me fond	45,902 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	14 Familje me fond	55,581 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	9 Familje me fond	35,719 lekë

Totali si Bashki 81 familje me fond 332,004 lekë

Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike
Rexhep Shaka



FONDI 6%

Periudha: KORRIK 2025

Bashkia Librazhd

Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	Vlera e përlogaritur për fondin 6%	Kompensi mi i Energjisë	Totali	Numri anëtarëve
1	Kujtim Ymerli Polisi	H00409064A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
2	Mariglen Qazim Polisi	I80706027W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792	1,288	6,080	3
3	Rabie Sadik Leka	G95628010G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
4	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Ymer Xhaferr Kala	G31020023L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049	1,288	4,337	3
6	Avni Reshit Stafa	H20620213J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
7	Jonuz Shadin Çota	G30206013H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	3
8	Sabri Hajdar Stafa	G71012046N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Lutfije Ali Roçi	E25406026F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
10	Shëfqet Elmaz Laçka	G90720242L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
11	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
12	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
13	Vera Mehmet Dada	I75404018N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
14	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
14	Total Njësia Administrative: Hotolisht			49,636	16,744	66,380	29
1	Dritan Nazmi Brahja	I30216010M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
2	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	2
3	Artur Musa Agastra	G10101021O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
4	Shyqyrie Belul Billoshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
6	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1

7	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
8	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
9	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
10	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
11	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
12	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
13	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
14	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
15	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
16	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
17	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
18	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
19	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
20	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
21	Bule Myhedin Kojku	H55125015N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
22	Irena Agim Balazi	I65427026D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,980	1,288	3,268	2
23	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
24	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
25	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
26	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
27	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,720	1,288	7,008	1
28	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
29	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
30	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
31	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2
32	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	3
32	Total Njësia Administrative: Librazhd			103,950	24,472	128,422	49
1	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
2	Ismet Shaip Balliu	F61209003T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,752	1,288	8,040	4
3	Nazif Mehmet Qostija	F90730127I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
4	Bashkim Reshit Biba	G70701144N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2

5	Nazmi Liman Ruçi	E60228033R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525		1,525	3
6	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
7	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,158	1,288	5,446	3
8	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Nadire Maksut Luka	E85901096E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Total Njësia Administrative: Orenje			29,279	6,440	35,719	19
1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
3	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
4	Astrit Shefqet Cura	H30624055Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Farije Hamit Lleshi	E15319014U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
6	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
7	Mexhit Nuredin Stërmugu	F90224131N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
8	Xhevahir Kadri Doçi	H40517080G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
9	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
10	Imer Sali Ballolli	G30520374Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
11	Nadire Mustafa Kasa	H26223016N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	3
12	Xhevrije Shahin Xhakeri	G65325034C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
12	Total Njësia Administrative: Polis			38,174	7,728	45,902	20
1	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
2	Serme Kamer Qoshku	G65702019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
3	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	-00	3,146	1
4	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
6	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
7	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
8	Trandafille Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
9	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
10	Xhane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
11	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
12	Gani Bajram Faqolli	G40720092D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2

13	Sabire Xhemal Shuli	A55716002R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
14	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
14	Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZH			42,701	12,880	55,581	18
81	Totali Bashkisë			263,740	68,264	332,004	135

Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike

Rexhep Shaka

P/Vendimi
J1=2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/08/2025

“Për disa ndryshime në **VKB nr.108 datë 27.12.2024** Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesem 2025-2027, **VKB nr.3 datë 31.01.2025** Për një shtesë në v.k.b. nr.108 .date 27.12.2024“Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesem 2025-2027”.

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024“Për Buxhetin e vitit 2025”, Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/08/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI :

1. Të miratojë shtesë fondi për paga dhe sigurime shoqërore për programin Trashëgimi kulturore, evente artistike dhe kulturore (8220) në vlerën 7,238,648 lekë.
2. Të miratojë shtesë fondi për paga dhe sigurime shoqërore për programin Shërbimet Policore (3140) në vlerën 300,000 lekë.
3. Të miratojë shtesë fondi për paga dhe sigurime shoqërore për programin Administrimi i Pyjeve dhe kullotave (4260) në vlerën 500,000 lekë.
4. Të miratojë shtesë fondi për paga dhe sigurime shoqërore për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar dhe Çerdhja e fëmijëve (10430) në vlerën 840,000 lekë.
5. Të miratojë shtesë fondi për paga dhe sigurime shoqërore për programin Shërbimet Publike (6260) në vlerën 6,935,000 lekë kodi institucionit 2 128 009.
6. Për sigurimin e këtyre fondeve të miratojë ndryshimet buxhetore si më poshtë :

❖ Trashëgimi kulturore, evente artistike dhe kulturore
Pakësim në strukturën buxhetore :

Grupi	Tit.	Kap.	Art.	Vlera në lekë
0 0	4940	0 1	609	2,000,000 lekë Fond Kontigjence
0 0	1110	0 1	602	540,000 lekë Tabela informuese shtigjesh
0 0	1110	0 1	602	207,360 lekë Monitor elektronik per aktivitete

Adresa: Sheshi “ Gjorg Golemi” email: www.bashkialibrazhd.gov.al, info@bashkialibrazhd.gov.

0 0	9120	0 1	602	2,489,800	lekë	Furnizim me ushqime 2024 (kursim nga kontrata nr.2678 datë 04.06.2024)
0 0	9120	0 1	602	1,233,688	lekë	Furnizim me mish kopshte cerdhe (kursim nga kontrata nr.1049 datë 26.02.2024).
0 0	9120	0 1	602	389,963	lekë	Blerje lende djegese naftë për ngrohje shkolla Mirake Plane (kursim nga kontrata nr.1042 datë 26.02.2024).
0 0	9120	0 1	602	37,658	lekë	Blerje lënd djegese naftë për ngrohje për shkollën e bashkuar Hotolisht shkolla 9-vjecare Hotolisht –Fshat (kursim nga kontrata nr.1044 datë 10.02.2024).
0 0	4260	0 5	602	245,000	lekë	Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjetesh(kursim nga kontrata nr.1215 datë 06.03.2024).
0 0	4260	0 1	602	95,179	lekë	Blerje karburant (kursim nga kontrata nr.1048 datë 26.02.2024).

Shtim në strukturën buxhetore:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke	
0 0	8220	0 1	600	6,134,884	lekë Shpenzime për paga personeli
0 0	8220	0 1	601	858,764	lekë shpenzime për sigurime shoqërore
0 0	8220	0 5	601	245,000	

❖ Shërbimet Policore

Pakësim në strukturën buxhetore :

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	3140	0 1	602	283,994	lekë Blerje karburant (kursim nga kontrata nr.1048 datë 26.02.2024).
0 0	3140	0 5	602	16,006	lekë Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjetesh(kursim nga kontrata nr.1215 datë 06.03.2024).

Shtim në strukturën buxhetore:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke	
0 0	3140	0 1	600	200,000	lekë Shpenzime për paga personeli
0 0	3140	0 1	601	83,994	lekë shpenzime për sigurime shoqërore
0 0	3140	0 5	601	16,006	lekë shpenzime për sigurime shoqërore

❖ Administrimi i Pyjeve dhe kullotave

Pakësim në strukturën buxhetore :

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	4260	0 1	602	500,000	lekë Blerje uniforma

Shtim në strukturën buxhetore:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke	
0 0	4260	0 1	600	350,000	lekë Shpenzime për paga personeli

0 0 4260 0 1 601 150,000 lekë shpenzime për sigurime shoqërore

❖ Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar dhe Çerdhja e fëmijëve
Pakësim në strukturën buxhetore :

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	9120	0 1	602	210,490 lekë	Blerje lend djegese naftë për ngrohje për shkollën e bashkuar Hotolisht shkolla 9-vjecare Hotolisht –Fshat (kursim nga kontrata nr.1044 datë 10.02.2024).
0 0	9120	0 1	602	111,500 lekë	Blerje gaz për ngrohje për gjimnazin I.Muca Librazhd (kursim nga kontrata nr.928 datë 19.02.2024).
0 0	3280	0 1	231	518,010 lekë	Mbrojtja lumore në lumin e Gostimes L=171m (vendi midis rruges dhe hidrocentralit) si dhe segmenti I perroit Sheh nga ura deri tek vendakimi me lumin e Gostimes (70m+10m) faza e III me kod projekti 1280531.

Shtim në strukturën buxhetore:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	10430	0 1	600	770,000 lekë	Shpenzime për paga personeli Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar
0 0	10430	0 1	601	70,000 lekë	shpenzime për sigurime shoqërore Çerdhja e Fëmijëve

❖ Shërbimet Publike

Pakësim në strukturën buxhetore kod institucioni 2 128 009

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	4520	0 1	600	3,106,000 lekë	Shpenzime për paga
0 0	4520	0 1	601	321,000 lekë	Shpenzime për sig. shoqërore

Shtim në strukturën buxhetore kod institucioni 2 128 009

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	6260	0 1	600	3,427,000 lekë	Shpenzime për paga personeli

Pakësim në strukturën buxhetore kod institucioni 2 128 001

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë	
0 0	9120	0 1	231	3,000,000 lekë	Ndërtim i shkolles 9-vjecare Lunik në fshatin Lunik Nj.Adm. Lunik Librazhd

0 0	3280	0 1	231	299,831	lekë	me kod projekti 1280551 (2128001) Mbrojtja lumore ne lumin e Gostimes L=171m (vendi midis rruges dhe hidrocentralit) si dhe segmenti I perroit Sheh nga ura deri tek vendakimi me lumin e Gostimes (70m+10m) faza e III me kod projekti 1280531(2128001)
0 0	1110	0 5	231	208,169	lekë	Mbikqyrje Asfaltim i rruges Lunik Prevalle Loti 2 Njesia administrative Lunik Bashkia Librazhd 1280543.

Shtim në strukturën buxhetore 2 128 009

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke	
0 0	6260	0 1	600	2,252,831	lekë Shpenzime për paga personeli
0 0	6260	0 5	600	208,169	lekë Shpenzime për paga personeli
0 0	6260	0 1	601	1,047,000	lekë shpenzime për sigurime shoqërore

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit , Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social,Drejtoria e Sherbimeve Publike .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETARI I BASHKISE
MARIGLEN DISHA

FINANCA/PAK
18.08.2025



5460
DT 14.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

LIBRAZHD

Nr. 208 Prot.

Librazhd me 13.08.2025

Lenda : Kerkese per shtese fondesh per Drejtorine e Sherbimeve Publike

Drejtuar:Grupit te Menaxhimit Strategjik

Bashkia Librazhd


Bashkengjitur kesaj shkrese po ju dergojme relacionin shpjegues mbi domosdoshmerin e shteses se fondeve per shpenzimet per pega dhe sigurime shoqerore per sektorin e sherbimeve publike .

Ju lutem merrni masa per miratimin e shteses se kerkuar per funksionimin normal te kesaj drejtorie .

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

DREJTOR

Agron GEGA



RELACION

MBI PLANIFIKIMIN E FONDEVE TE NEVOJSHME PER PAGAT DHE SIGURIMET SHOQERORE PER DRJETORINE E SHERBIMEVE PUBLIKE

Drejtuar : Grupit te Menaxhimit Strategjike

Bashkia Librazhd

Me Vendim Te Keshillit te Bashkise Librazhd Nr.119 Date 27.12.2024 "Per krijimin e Drejtorise se Sherbimeve Publike "si institucion ne varesi te Bashkise Librazhd " eshte miratuar krijimi I Drejtorise se Sherbimeve Publike, institucion ne varesi te Bashkise Librazhd , I cili nga data 05.02.2025 funksionon si institucion me Nipt me vete dhe per kryejen e aktiviteit te saj ka buxhet te miratuar me Vendim te Keshillit te Bashkise Nr. 108, date 27.12.2024 " Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 te Bashkise Librazhd , programit perfundimtar buxhetor afatmesem 2025-2027", konfirmuar nga Prefektuara Elbasan me shkresen me nr. 08/1 prot, date 15.01.2025 ".

Buxheti i kesaj drejtorie eshte miratuar per Sektorin e Sherbimeve Publike dhe Sektorin e Mirembajtjes se Rrugeve Rurale , buxhet ne te cilin perfshihen shpenzimet per pagat e punonjeseve , shpenzimet per sigurimet shqerore e shendetsore si dhe shpenzimet operative per realizimin e misionit dhe objektivate per te cilat eshte krijuar kjo drejtori .

Gjate analizes se realizimit te treguesve te buxhetit te kesaj drejtorie per peiudhen janar -korrik 2025 dhe perlogaritjeve te bera per fondet e nevojshme per pagat dhe sigurimet shqerore per punonjesit deri ne fund te vitit 2025 , rezulton qe per sektorin e sherbimeve publike fondi per paga dhe sigurime shqerore i planifikuar ne fillim te vitit eshte i pamjaftueshem per perballimin e ketyre shpenzimeve , ndersa ne sektorin e rrugeve rurale kemi teperice fondesh . Nje tablo me e qarte e kesaj situate jepet ne tabelen me poshte :

Ne Leke

Sektor	Nr.punonjese	Artikulli	Shpenzime mujore	Shpenzime Gusht-Nentor 2025	Fakti Dhjetor - Mars 2025 BASHKIA	Fakti Mars - Korrik 2025 Ndermarria	Totali I Shpenzimeve 2025	Fondi I vecante	Totali shpenzimeve te pritshme 2025	Buxheti I miratuar 2025	Diferenca
RRUGET	63	Paga(600)	3,173,851	12,695,404	7,315,368	17,940,144	37,950,916	500,000	38,450,916.00	41556933	3,106,017.00
RRUGET		Sigurime (601)	530033	2,120,132	1,190,927	2,977,064	6,288,123	-	6,288,123.47	6609391	321,267.53
SHERBIMET	59	Paga(600)	3,329,199	13,316,796	6,637,847	18,989,100	38,943,743	500,000	39,443,743	33556169	(5,887,574.00)
SHERBIMET	122	Sigurime (601)	555,976	2,223,905	1,007,555	3,151,751	6,383,211	0	6,383,211	5337029	(1,046,181.93)

Pra sic shihet edhe nga tabela me sipers sipas perlllogaritjeve te bera per realizimin e prishem te vitit 2025 , teprice fondesh ne programin buxhetor te rrugeve rurale prej +3,427,284 leke dhe diference tek programi I buxhetor I sherbimeve publike ne vleren -6.933.759 leke .

Per mbulimin e shpenzimeve per paga e sigurime shogorore per sektorin e sherbimeve publike kerkojme qe teprica e perlllogaritur tek programi I rrugeve rurale te kaloje tek programi I sherbimeve publike sipas tabelës me poshte :

Ne Leke

Sektor	Programi buxhetor	Artikull	Pakesim	Shtim
Rrugët Rurale	00 04520 01	600	3.106.000	
Rrugët Rurale	00 04520 01	601	321.000	
Sherbimet Publike	00 06260 01	600		3,427,000
TOTALI			3.427.000	3.427.000

Per vleren prej 2.461.000 leke per paga dhe vleren prej 1.047.000 leke per sigurime , per sektorine e sherbimeve ju lutem merri masa per gjejen e burimeve finaciare per mbulimin e ketyre shpenzimeve deri ne fund te vitit 2025 .

Per sa me siper kerkojme shtese plani per shpenzimet per paga dhe sigurimet shogorore per programin buxhetor 00 06260 01

Totali	Risiperndarja	Burime te tjera
Paga	5.888.000 leke	2.461.000
Sigurime	1.047.000 leke	1.047.000
Totali	6.935.000 leke	3.508.000

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

DREJTOR I SHERBIMEVE PUBLIKE

Konceptoi: B. Agastra



Agrom-GEGA




RELACION

Në vijim të shqetësimit të ngritur për mungesën e një objekti shkollor në fshatin Lunik, u analizuan mundësitë reale për ndërtimin e saj brenda këtij viti shkollor. Pas shqyrtimit të situatës, rezulton se ndërtimi i shkollës nuk mund të realizohet menjëherë për arsye si më mëposhtme:

1. Koha e kufizuar – Viti shkollor fillon në shtator dhe procesi i prokurimit, ndërtimit dhe kolaudit të objektit nuk mund të përfundojë brenda këtij afati të shkurtër, duke rrezikuar cilësinë e punimeve.
2. Nxënësit nuk kanë një godinë ku të zhvillojnë procesin mësimor, gjë që cënon drejtpërdrejtë të drejtën e tyre themelore për arsimin dhe rrezikon vijimësinë e shkollimit.

Ndërhyrja e menjëhershme nuk është e realizueshme për këtë vit, por është e domosdoshme që ndërtimi i shkollës në Lunik të parashikohet si prioritet kryesor për vitin e ardhshëm, në mënyrë që nxënësit të kenë një godinë të re dhe të denjë për procesin arsimor.

Sigurimin e fondeve përmes bashkëfinancimit nga Këshilli i Qarkut, buxhetit vendor, si dhe përmes donatorëve të huaj ose organizatave ndërkombëtare.

P/Sektori i Projekteve dhe Investimeve Publike

Adela Haskurti



RELACION

Për: Shtesë fondi në zërin “Paga dhe sigurime” për gjashtëmujorin e dytë të vitit.

Në zbatim të programeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe për të garantuar vijueshmërinë e shërbimeve publike, është kryer një analizë e situatës buxhetore për gjashtëmujorin e parë të vitit. Nga kjo analizë ka rezultuar nevoja për shtesë fondi në zërin “Paga dhe sigurime” për personelin e angazhuar në disa programe specifike për periudhën korrik–dhjetor konkretisht :

- Trashëgimi kulturore, evente artistike dhe kulturore (8220) në vlerën 7,238,648 lekë.
- Shërbimet Policore (3140) në vlerën 300,000 lekë.
- Administrimi i Pyjeve dhe kullotave (4260) në vlerën 500,000 lekë.
- Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar dhe Çerdhja e fëmijëve (10430) në vlerën 840,000 lekë.

Fondi i kërkuar do të sigurohet nga kursimet e krijuara si rezultat i përfundimit të disa kontratave dhe menaxhimit efikas të tyre gjë e cila na lejon rishpërndarjen e tyre në zëra prioritarë duke zbatuar ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 pika a) për njësitë e qeverisjes vendore:

1. Furnizim me ushqime kopshte dhe çerdhe për vitin 2024;
2. Furnizim me mish kopshte çerdhe për vitin 2024;
3. Blerje lende djegese naftë për ngrohje shkolla Mirake Plane për vitin 2024;
4. Blerje lënd djegese naftë për ngrohje për shkollën e bashkuar Hotolisht shkolla 9-vjecare Hotolisht –Fshat për vitin 2024;
5. Blerje gaz për ngrohje për gjimnazin "I.Muça" Librazhd për vitin 2024;
6. Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjeteve për vitin 2024;
7. Blerje Karburant (naftë) për vitin 2024;

Miratimi i këtij propozimi nuk sjell shtesë të buxhetit total vjetor të bashkisë, por vetëm rishpërndarje të fondeve ekzistuese, duke garantuar eficiencë dhe transparencë në përdorimin e tyre.

P/Buxhetit

Emanuela Cekrezi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/08/2025

“Për disa ndryshime në **VKB nr.108 datë 27.12.2024** Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesem 2025-2027, **VKB nr.3 datë 31.01.2025** Për një shtesë në v.k.b. nr.108 .date 27.12.2024“Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesem 2025-2027”.

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024“Për Buxhetin e vitit 2025” ,Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/08/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI :

1. Të miratojë shtesë fondi shpenzime për aktivitete për vitin 2025 në vlerën 2,000,000 lekë.
2. Të miratojë shtesë fondi për Drejtorinë e Shërbimet Publike (6260) për blerje material per riparimin e urave ne bashki dhe njesi administrative në vlerën 500,000 lekë.
3. Të miratojë shtesë fondi për Drejtorinë e Shërbimet Publike (4520) për blerje materiale për mirëmbajtje dhe riparim lere betoni në Njësitë Administrative të bashkisë Librazhd në vlerën 1,200,000 lekë.
4. Për sigurimin e këtyre fondeve të miratojë ndryshimet buxhetore në strukturën si më poshtë:

Pakësim

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	4260	0 1	231	2,000,000 lekë Hartim plan mbareshtimi ne ekonomite pyjore te bashkise Librazhd kod 1280552

Shtesë

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	8220	0 1	602	2,000,000 lekë shpenzime për aktivitete .

Pakësim

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	6260	0 1	231	500,000 lekë Blerje betoniere per drejtorine e Puneve

Adresa: Sheshi “ Gjorg Golemi” email: www.bashkialibrazhd.gov.al, info@bashkialibrazhd.gov.

publike dhe mirembajtje e rruges kod
1280478 ;kod institucioni 2 128 001

Shtesë

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	6260	0 1	602	500,000 lekë	Blerje material per riparimin e urave ne bashki dhe njesi administrative 2 128 009

Pakësim

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	4260	0 5	231	600,000 lekë	Riparim lere betoni Nj.Adm Polis kod projekti 1280563
0 0	4260	0 5	231	600,000 lekë	Riparim lere betoni Nj.Adm Stebleve kod projekti 1280564

Shtesë

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	4520	0 5	602	1,200,000 lekë	Blerje materiale për mirëmbajtje dhe riparim lere betoni në Njësitë Administrative të bashkisë Librazhd

5. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit , Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETARI I BASHKISE
MARIGLEN DISHA

FINANCA/20.08.2025

5559

DE 19.08.2025



OK.22.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

LIBRAZHD

Nr. 210 Prot.

Librazhd me 13.08.2025

Lenda : Kerkese per shtese fondesh per Drejtorine e Sherbimeve Publike

Drejtuar:Grupit te Menaxhimit Strategjik

Bashkia Librazhd

Bashkengjitur kesaj shkrese po ju dergojme relacionin shpjegues mbi domosdoshmerin e shteses se fondeve per shpenzimet operative dhe blerje paisjesh

Ju lutem merrni masa per miratimin e shteses se kerkuar per funksionimin normal te kesaj drejtorie .

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

DREJTOR

Agron GEGA



RELACION

MBI SHITESEN E FONDEVE TE NEVOJSHME PER SHPENZIME OPERATIVE PER DRJETORINE E SHERBIMEVE PUBLIKE

Drejtuar : Grupit te Menaxhimit Strategjike

Bashkia Librazhd

Me Vendim Te Keshillit te Bashkise Librazhd Nr.119 Date 27.12.2024 "Per krijimin e Drejtorise se Sherbimeve Publike "si institucion ne varesi te Bashkise Librazhd " eshte miratuar krijimi I Drejtorise se Sherbimeve Publike, institucion ne varesi te Bashkise Librazhd , I cili nga data 05.02.2025 funksionon si institucion me Nipt me vete dhe per kryerjen e aktivitetit te saj ka buxhet te miratuar me Vendim te Keshillit te Bashkise Nr. 108, date 27.12.2024 " Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 te Bashkise Librazhd , programit perfundimtar buxhetor afatmesem 2025-2027", konfirmuar nga Prefektuara Elbasan me shkresen me nr. 08/1 prot, date 15.01.2025 ".

Buxheti i kesaj drejtorie eshte miratuar per Sektorin e Sherbimeve Publike dhe Sektorin e Mirembajtjes se Rrugeve Rurale , buxhet ne te cilin perfshihen shpenzimet per pagat e punonjesve , shpenzimet per sigurimet shoqerore e shendetsore si dhe shpenzimet operative per realizimin e misionit dhe objektive per te cilat eshte krijuar kjo drejtori .

Gjate analizes se realizimit te treguesve te buxhetit te kesaj drejtorie per periudhen janar -korrik 2025 dhe nga verifikimet dhe puna ne terren te kesaj drejtorie, rezulton se ne buxhetin e vitit 2025 nuk jane planifikuar shume shpenzime te domosdoshme per kryerjen e sherbimeve.Ne jemi drejtuar me shkrese edhe me heret prane Bashkise per shtese fondesh per realizimin e sherbimeve te domosdoshme per te gjitha funksionet dhe detyrat qe kjo drejtori mbulon.

Per kete arsye po ju drejtohem serish per shtese te fondeve buxhetore si ne sektorin e sherbimeve ashtu dhe ne sektorin e Rrugeve Rurale .Kerkesat per fonde dhe emertimet e shpenzimeve qe kerkojme te kryejme jepen ne tabelen si me poshte :

SEKTORI	STRUKURA BUXHETORE	EMERTIMI I SHPENZIMEVE	VLERA NE LEKE	
Sherbimet Publike	00 6260 01 602	Blerje material per riparimin e trotuareve dhe shesheve	705.000	
	00 6260 01 602	Blerje material per lyerje e sherbetime te zyrave te institucioni dhe zyrave te bashkise	120.000	300.000 ✓
	00 6260 01 602	Blerje material per mirembajtje te rrethimeve te institucioneve , parqeve e lulishteve	102.500	10.000.000
	00 6260 01 602	Blerje vegla pune per punonjesit	41.800	10.000.000
	00 6260 01 602	Blerje material per riparimin e urave ne Bashki dhe njesite administrative	629.500	10.000.000
	00 6260 01 602	Blerje materiale per riparimin e tarracave , cative te shkollave dhe institucioneve	450.000	
	00 6260 01 231	Blerje makineri e paisje (prerese pllakash , kompaktor pllakash)	132.000	10.000.000
TOTALI SHERBIMEVE PUBLIKE			2.180.800	
Rruget Rurale	00 4520 01 231	Blerje kamion per sektorin e rrugeve rurale	1.000.000	10.000.000


	00 4520 01 602	Blerje tombino e materiale per mirmbajtjen e rrugeve rurale	720.200	2022.002
TOTALI I RRUGEVE RURALE			1.720.200	
TOTALI I PERGJITHSHEM			4.000.000	

Per sa me siper kerkojme shtese plani per shpenzimet kerkuara me siper ne vleren totale prej 4.000.000 leke te shperndara 2.180.800 leke per sektorin e sherbimeve publike dhe 1.720.200 leke per sektorin e rrugeve rurale

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

DREJTOR I SHERBIMEVE PUBLIKE

Agron GEGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME

5427

Dt 13.08.2025

Librazhd më, _____

Lënda: Kërkesë

Drejtuar: GRUPIT TË MENAXHIMIT STRATEGJIK (GMS)

Bazuar në kalendarin e aktiviteteve vjetore që Sektori i Arsimit Kulturës realizon dhe ka të planifikuar në buxhet për vitin 2025, ju bëjmë me dije se fondi aktual i parashikuar nuk mbulon në mënyrë të plotë kostot për realizimin e tyre deri në fundvit. Në këtë mënyrë kërkojmë shtim fondi tek shpenzime për aktivitete. Fondi i parashikuar është rezauruar për arsye: shtimit të kostove të logjistikës dhe shërbimeve teknike, shpenzime të paparashikuara për promovim dhe organizim. Aktivitetet që janë organizuar në periudhën Janar- Gusht janë:

- Aktiviteti i 7- 8 Marsit
- Dita e Verës
- 5- Maji
- Festa e Luleve
- Aktiviteti i Hapjes së sezonit Turistik
- Festa e 1 Qershorit
- Aktiviteti në nder të dy poetëve martir Genc Leka dhe Vilson Blloshmi
- Aktiviteti Vere dhe Portokalle
- Festa e Shtegtarëve
- Teatri i Kukullave
- Cirku Kombëtar
- Festat Lokale (Polis, Qendër, Steblevë)

Theksojmë që ky kalim është i nevojshëm për realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara për periudhën Shtator -Dhjetor.

Bashkangjitur gjendet preventivet e aktiviteteve të planifikuara për periudhën Gusht- Dhjetor.

Duke shpresuar në miratimin e kërkesës sonë,

Përkujtim krijimi i Çetës Partizane të Çermenikës

Nr.	Emërtimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1	Baner njoftues	cope	1	3,500	3,500
2	Kurora me lule	cope	9	5,000	45,000
	Totali				48,500
	T.V.SH				9700
	Totali me T.V.SH				58,200
	Grupi Valles	Persona	8	2500	20,000
	TOTALI				78,200

Festat lokale

Nr.	Emërtimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1	Festa e Qarrishtes	cope	1	50000	50000
2	Festa e Hotolishtit	cope	1	50000	50000
3	Festa e Orenjës	cope	1	50000	50000
	Totali				150,000

Festa e Dritave

Nr.	Emërtimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1	Baner njoftues	cope	1	3,500	3,500
2	Skene me qera	cope	1	300,000	300,000
	Totali				303,500
	T.V.SH				60,700
	Totali me T.V.SH				

					364,200
1	Kënetare	persona	3	120000	360,000
	TOTALI				724,200

10 Nentori Çlirimi i Librazhdit

Nr.	Emërtimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1	Certifikate Mirenjohje	cope	15	300	4,500
2	Kurora me lule	cope	9	5,000	45,000
3	Banderol	cope	1	9,000	9,000
	Totali				58,500
	T.V.SH				11,700
	Totali me T.V.SH				70,200
	Grupi Valles	persona	12	2500	30000
	TOTALI				100,200

Koncert, Festat e 28-29 Nentorit


Nr.	Emërtimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1	Baner njoftues	cope	1	3,500	3,500
2	Baner skene	cope	1	35,000	35,000
	Totali				38,500
	T.V.SH				7,700
	Totali me T.V.SH				46,200
	Valltar	persona	12	2500	30000
	Kengetar te zones	persona	3	10000	30000
					60000
	TOTALI				106,200

**Koncert Festiv I Vitit te Ri +
Ndezja e Dritave**

Nr.	Emërtimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1	Baner njoftues	cope	1	3,500	3,500
2	Baner skene	cope	1	28,000	28,000
3	Skena	cope	1	120,000	120,000
4	Fonia + ndriçim	cope	1	120,000	120,000
	Totali				271,500
	T.V.SH				54,300
	Totali me T.V.SH				325,800
	Valltar	persona	12	2500	30000
	Prezantues	persona	2	2000	4000
	Kengetare	persona	4	120,000	480000
					514000
	TOTALI				839,800


TOTALI	2,000,000
---------------	------------------

Konceptoi: M. Omeri



DREJTOR

Elona Koci





5690

01.25.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. ____ Prot.

Librazhd më: ____ / ____ / 2025

Lënda: Kërkesë për mirëplanifikimi investimi

Dërgohet: Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës të bashkisë Librazhd
GMS bashkia Librazhd

Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në bazë të planifikimeve të bëra ndër vite ka arritur që të realizojë me fondet e bashkisë hartimin e planeve të Mbarështimit të ekonomive pyjore si më poshtë :

1. Dardhë – Xhyrë 2019
2. Lugina e Kostenjës 2020
3. Kuturman 2024-2025

Për vitin 2025-2026 në planifikimin e buxhetit në planin e investimeve në sektorin e pyjeve dhe kullotave të bashkisë është planifikuar fondi me vlerë **2 000 000 lekë me Tvsh** për hartim të planit të mbarështimit.

Mbështetur në VKM Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik” Shtojca 1 pika 2” Tarifat për veprimtarinë shërbime profesionale për projekte: a) hartim i planit 10-vjeçarë të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave publike , bazuar në llogaritjet e bëra (sipërfaqe,forma e përdorimit) për çdo ekonomi pyjore të bashkisë Librazhd që nuk ka një plan mbarështimi **kjo vlerë nuk është e mjaftueshme për të realizuar një plan mbarështimi.**

Për këtë kërkojmë nga ana Juaj që fondi i planifikuar për vitin 2025 me emërtim “Hartim Plan Mbarështimi” të shtohet si vlerë në planifikim e buxhetit për vitin 2026 ashtu sikur ju kemi dërguar shkresën për planifikim shpenzimesh në fondin pyjor kullosor të bashkisë pasi kjo vlerë nuk mund të përdoret për vitin 2025 për emërtimin e përcaktuar për t’u përdorur. (Bashkëngjitur shkresa)

Bashkëngjitur kërkesës do të gjeni :

- a) VKM Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik”
- b) Koston për secilën ekonomi pyjore që kërkohet për të hartuar planet e mbarështimit të ekonomive pyjore në bazë të sipërfaqes dhe formës së përdorimit nga subjekte të licensuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

P/Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Ing.Aleksander Brazhda

Drejtori

Hysni Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Amendim
51 = 4

BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI
P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/08/2025

**“PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RITJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE TË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/08/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

V E N D O S I:


1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Librazhd në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënien e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Librazhd në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Librazhd si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillin të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Librazhd të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet Ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;

5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Librazhd të përfaqësojë Bashkinë Librazhd në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Librazhd nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.
6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Buxhetit , Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social të për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

KRYETARI I BASHKISE
MARIGLEN DISHA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

“PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK
SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RRITJEN E
KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË
NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Të nderuar Këshilltarë!

I. Qëllimi i projektvendimit dhe objektivat që synohen të arrihen dhe bazueshmëria ligjore.

Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) në mënyrë që ato të ushtrjnë këto funksione sipas ligjit, standarteve, me efektivitet, efencë dhe në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare, si dhe me standardet e BE-së. Në ligj parashikohet trajnim sistematik dhe buxhetor i stafit të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64 shkonja “h”), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak (Neni 51 pika 4).

Ky projektvendim ka si qëllim mundësimin e zhvillimit dhe kualifikimii profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të bashkisë.

Ky projektvendim ka si objektiva:

- Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.
- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.

- Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.
- Aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Krijimi i një strukture të dedikuar për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta (SPK) në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 pika 5. Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Palët përcaktojnë ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave të SKP.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

II. Vlerësimi i projektaktit në raport me politikat dhe prioritet e bashkisë dhe të Qeverisë së Shqipërisë.

Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët. Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e hartimit, zbatimit dhe moniorimit të politikave të bashkisë, cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe aftësia e bashkisë për t’u përgjigjur cilësisht nevojave dhe tendencave zhvillimore në nivel vendor. Cilësia e politikave për zhvillim të qëndrueshëm vendore dhe për ofrimin e shërbimeve vendore cilësore dhe për të gjithë komunitetet, varen në një masë të madhe nga njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe profesionalizimi i të zgjedhurive vendorë, i nëpunësve publikë të administratës së bashkisë si dhe i punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë.

Vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballlet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Procesi i decentralizimit të funksioneve tek bashkitë si dhe rritja e kërkesave për shërbime nga qytetarët dhe komunitetet e bëjnë të domosdoshme rifreskimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve vendorë. Gjithashtu edhe politikat kombëtare për të modernizuar administratën publike si dhe për të digjitalizuar qeverisjen dhe shërbimet administrative, bëjnë të domosdoshme kualifikimin, profesionalizimin dhe modernizimin e administratës publike të NJVV-ve.

Trajnimet për zyrtarët e NJVV-ve janë ofruar nga subjekte të ndryshme shtetërore dhe në një masë të madhe nga programet e huaja të asistencës teknike, por këto trajnime kanë qenë sporadike, nuk kanë qënë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat konkrete të NJVV-ve. Trajnimet nuk janë ofruar për të gjitha funksionet e NJVV-ve, dhe për më tepër kanë lënë shpesh jashtë vëmendjes të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jo-nëpunës civil të NJVV-ve. Trajnimet janë fokusuar kryesisht në përmbushjen e nevojave të përgjithshme horizontale, duke mos adresuar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar temat vertikale që lidhen me funksionet dhe shërbimet specifike sektoriale të qeverisjes vendore. Për më tepër, nuk ka ekzistuar ndonjë proces i institucionalizuar dhe i rregullt konsultimi me zyrtarët e NJVV-ve për identifikimin e nevojave për trajnime apo për përmbajtjen e kurrikulave të trajnimit, veçanërisht ato sektoriale.

ASPA dhe institucione të tjera shtetëror kanë ofruar një grup shërbimesh trajnimi për NJVV-të sipas parashikimeve ligjore, por ato mbeten të pamjaftueshme përkundrejt sfidave që NJVV-të përballen dhe pritet që të përballen në kuadër të procesit të integritetit në BE.

Për pasojë, NJVV-të nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat specifike të punonjësve të tyre, duke krijuar një hendek të madh në përmbushjen e kërkesave për trajnim dhe kjo ka sjell në pah nevojën për një qasje më strategjike dhe të integruar dhe një strukturë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe kualifikimin profesional të zyrtarëve të NJVV-ve, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat në rritje për shërbime cilësore të vetëqeverisjes vendore.

Numri i zyrtarëve të NJVV-ve ka ardhur në rritje, nga rreth 21,442 (2015), në rreth 32,000 (2021), 37,518 (2022), dhe rreth 39,000 (2023), ku të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jashtë shërbimit civil përbëjnë shumicën e zyrtarëve të NJVV-ve, rreth 85% (*White Paper për Akademinë-2024*). Pavarësisht rritjes së numrit të zyrtarëve të NJVV-ve, mbështetja financiare e NJVV-ve për trajnimet e tyre mbetet e ulët.

Por ndërkohë që numri i zyrtarëve të NJVV-ve dhe nevoja e tyre për trajnim ka ardhur në rritje, asnjë strukturë nuk ka pasur mandatin apo kapacitetin për të trajnuar në mënyrë të plotë, praktike dhe në kohën e duhur të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e institucioneve e ndërmarrjeve në varësinë e NJVV-ve.

III. Koncepti, procesi, aktorët dhe modalitetet për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Ngritja e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si një strukturë të dedikuar për trajnim e zyrtarëve të NJVV-ve, përfaqëson realizimin e një nisme të kahershme dhe një kërkesë

të artikuluar e lobuar prej vitesh nga NJVV-të, me synimin për të përmbushur nevojat e mëdha dhe në rritje për aftësimin dhe kualifikimin e të gjithë zyrtarëve të tyre.

Vizioni për të ngritur një strukturë të dedikuar për trajnimin e zyrtarëve të NJVV-ve u materializua në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimi dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 miratuar me VKM nr. 252, datë 20.4.2023, dhe u mbështet nga grupi ndër-institucional të punës të ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr.6 datë 12.01.2024, në takimet e të cilit morën pjesë morën pjesë aktive edhe shoqatat e NJVV-ve. Procesi i diznejimit të Akademisë u mbështet me ekspertizë të huaj dhe vendase, të financuar nga Qeveria Svicerane dhe Qeveria Suedeze, u realizua në konsultim me kryetarë të bashkive dhe të këshillave bashkiakë të spektrit të ndryshëm politik, si dhe me kryetarë të këshillave të qarqeve. Procesi i diznejimit të Akademisë u realizua me përfshirjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe me praninë e zyrës së Komisionit Evropian në Tiranë dhe të donatorëve të tjerë. Për diznejimin e Akademisë u morën parasysh 10 modele të shkollave dhe qendrave të trajnimit për administratën publike në Evropë dhe në rajon, si dhe modele të qendrave të trajnimit në Shqipëri. Ndërkohë, me shkresën nr. 532 prot., datë 18.09.2024 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) iu drejtua 61 kryetarëve të bashkive, duke kërkuar konfirmimin për përfshirjen në buxhetin e vitit 2025 të kontributit financiar të secilës bashki për të mbështetur trajnimet e zyrtarëve të tyre përmes një strukture të dedikura dhe në bazë të numrit të punonjësve të tyre.

Nga ana e NJVV-ve dhe në funksion të realizimit të iniciativës për ngritjen e Akademisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bashkive, me vendimin e saj të datës 04.09.2024, dakortësoi angazhimin e bashkive të Shqipërisë për mbështetjen e kësaj iniciative, si dhe për bashkëfinancimin e Akademisë në vlerën 50% të shpenzimeve operationale dhe të trajnimeve. Në vijim të këtyre iniciativave, Grupi Ndër-institucional i Punës miratoi Dokumentin e Politikës (White Paper) për Akademinë (27 Shtator 2024), dokument që më pas u konsultua edhe në mbledhjen e Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeveri Vendore (Dhjetor 2024).

Në përgjigje të angazhimit të Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur ngritjen e Akademisë si dhe të mbështetjes së shoqatave të NJVV-ve për ngritjen e Akademisë, këshillat bashkiakë konfirmuan njëzëri mbështetjen e tyre për nevojën e ngritjes së Akademisë, përmes miratimit të një fondi për trajnimet e zyrtarëve të bashkisë e që do t'i vihej në dispozicion Akademisë në momentin e regjistrimit të saj. Ky angazhim financiar përbën një shprehje e vullnetit të fortë të bashkive për ngritjen dhe financimin e Akademisë, si dhe përbën një element të rëndësishëm për avancimin e procesit të ngritjes së subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP).

Akademia që propozohet të ngrihet si personi juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, do të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për të mbështetur dhe përmirësuar kapacitetet e NJVV-ve në Shqipëri duke përfshirë hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara, administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, ofrimi i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-të për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e objektivave në lidhje me zhvillimin e burimeve të tyre njerëzore.

Ngritja e Akademisë është thelbësore për t'i mundësuar NJVV-ve përballimin e sfidave për rritjen e cilësisë së jetës, zhvillim të qëndrueshëm të territorit dhe komuniteteve vendore si dhe

sfidave që po sjell procesi i integritetit të Shqipërisë në BE. Vlerësohet se 70% e *acquis* zbatohet nga qeveritë vendore dhe rajonale dhe NJVV-të do të kenë një rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe kjo është arsyeja pse niveli i njohurive dhe aftësive të zyrtarëve të NJVV-ve, për të përballuar këto procese, merr një rëndësi të veçantë.

Synohet që ofrimi i trajnimeve të përfshijnë tema specifike dhe sektoriale “vertikale” që lidhen me funksionet e NJVV-ve dhe me rreth 41 shërbimet e vetëqeverisjes vendore të tilla si Zhvillimi i Territorit, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike, Shërbimet Sociale; Mbrojtja e Mjedisit; Bujqësia; Zhvillimi Rural; Pyjet dhe Kullotat Publike; Zhvillimi Ekonomik Vendor, Siguria Publike, etj. Programet e trajnimit do të hartohen bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, do të jenë paktike dhe dinamike, ndërkohë që hartimi i kurrikulave dhe dhënja e trajnimeve do të koordinohet me ASPA për të evituar mbivendosje të trajnimeve të ofruara.

Përfituesit kryesorë të shërbimeve janë nëpunësit civilë dhe punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe të zgjedhurit vendorë, që përbëjnë rreth 39,000 persona.

Kjo përfshirje e gjerë ndihmon në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 (5). Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërliiden dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

Staregjia decentralizimit

Themelimi i OJF-së si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe NJVV-ve, përmes aktit themelues dhe statutit, kërkon në të njëjtën kohë miratimin nga të gjithë këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve të marrëveshjes për anëtarësimin në Akademi, SKP në formë OJF-je, si dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga ministri përgjegjës për çështjet vendore sipas autorizimit të dhënë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes VKM 405 dt.16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të republikës së shqipërisë”*. Sipas këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka marrë angazhimin të mbështesë financiarisht Akademinë përmes mbulimit të kostove fillestare të themelimit të saj si subjekt i kompetencave të përbashkëta, si dhe të financojë jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të Akademisë për tri vitet e para të funksionimit për përmbushjen e objektivave të saj.

Hapi vijues në këtë proces është miratimi i marrëveshjes nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar. Pas përfundimit të këtij procesi të miratimit, do të vijohet me regjistrimin e personit juridik në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8788/2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”*, të ndryshuar.

IV. Propozimi për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 2, pika 1, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55, pikat 3, të ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”* (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 *“Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”*, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 *“Për organizatat jofitimprurëse”* (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”*, i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësisë të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi, të quajtur *“Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)”*.


TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj, TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënien e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën

përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administrojnë një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Librazhd në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Librazhd si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë së Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Librazhd të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet Ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA--s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Librazhd në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Librazhd nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë së TALGA-s.

KRYETARI I BASHKISË

MARIGLEN DISHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME

Lënda: Informacion mbi përgatitjet për vitin e ri shkollor

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Librazhd ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe infrastrukturore në institucionet arsimore nën varësinë e saj.

Sistemet e ngrohjes në pjesën më të madhe të godinave funksionojnë me lëndë djegëse druri, ndërsa ndërtimet e reja janë pajisur me kalaja që përdorin naftë apo gaz.

Gjatë këtij viti, Shkolla “Shefqet Dosku” Dorëz ka përfunduar një rikonstruksion të plotë dhe tashmë do të presë nxënësit në ambiente të reja, të pajisura edhe me palestër bashkëkohore.

Paralelisht, ka nisur procesi i përgatitjeve për rikonstruksionin e Shkollës 9-Vjeçare “Vilson Blloshmi”, dhe për këtë janë marrë masa për sistemimin e përkohshëm të nxënësve në një institucion tjetër arsimor, në mënyrë që procesi mësimor të mos ndërpritet.

Ndërkohë, ka përfunduar procesi i lysterjes dhe mirëmbajtjes në të gjitha kopshtet dhe çerdhet e qytetit, duke përmirësuar ndjeshëm ambientet ku zhvillohet edukimi i fëmijëve. Mirëmbajtja e shkollave, sipas kërkesave të drejtorëve, po koordinohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ndërhyrjet po realizohen aty ku ka më shumë nevojë.

Bashkia Librazhd është e angazhuar që deri më datë 8 shtator 2025 të përfundojë çdo proces përgatitor, në mënyrë që viti i ri shkollor të nisë në kushte optimale.

DREJTORI

Elona Koci